verifiko.info

Udhëzues praktikë për prindër/mësimdhënës për Roblox

ROBLOX

Udhëzuesi përdor pamje reale të aplikacionit dhe shpjegime të shkurtra poshtë tyre.



Roblox: siguria dhe kontrolli prindëror

> **Lidhni një llogari prindi, pastaj caktoni kufijtë për përmbajtjen, kohën, komunikimin dhe shpenzimet.**

Prindi duhet të ketë llogari të veçantë Roblox me privilegje prindërore. Roblox mund të kërkojë verifikimin e moshës së prindit para lidhjes së llogarive.





1 Lidhni llogarinë e prindit

Hapi 1 Në llogarinë e fëmijës, hapni **More → Settings.**

Hapi 2 Zgjidhni **Parental Controls.**

Hapi 3 Prekni Add parent dhe shkruani emailin që përdoret në llogarinë Roblox të prindit.

Hapi 4 Hapni emailin e konfirmimit, hyni me llogarinë e prindit dhe pranoni lidhjen.





2 Vendosni nivelin e përmbajtjes

Hapi 1 Në llogarinë e prindit, hapni **Settings → Parental Controls.**

Hapi 2 Zgjidhni fëmijën dhe hapni **Content restrictions → Content maturity.**

Hapi 3 Zgjidhni nivelin që i përshtatet moshës dhe pjekurisë së fëmijës.

Hapi 4 Te **Blocked experiences**, bllokoni lojëra të veçanta që nuk dëshironi të hapen.



3 Vendosni nivelin e përmbajtjes

Hapi 1 Në **Parental Controls**, te **Screen time** prekni **Manage.**

Hapi 2 Hapni **Screen time limit.**

Hapi 3 Te **Daily limit**, zgjidhni kohën maksimale të lejuar për çdo ditë.

Hapi 4 Kontrolloni **Top experiences** për të kuptuar cilat lojëra përdoren më shumë.



4 Menaxhoni komunikimin

Hapi 1 Në **Parental Controls**, hapni **Communication → Experience chat**.

Hapi 2 Zgjidhni kush mund të bisedojë publikisht me fëmijën.

Hapi 3 Kufizoni **Direct chat** dhe **Party** në **Friends** ose **No one**, sipas moshës.

Hapi 4 Rishikoni listën e miqve së bashku me fëmijën dhe largoni persona të panjohur.





5 Vendosni kufirin e shpenzimeve

Hapi 1 Në **Parental Controls**, hapni **Spending restrictions.**

Hapi 2 Zgjidhni **Monthly spending limit.**

Hapi 3 Shkruani shumën maksimale mujore dhe prekni **Update.**

Hapi 4 Aktivizoni njoftimet për shpenzime që prindi të njoftohet për blerjet me Robux.

Informacione shtesë

- Përdorni **Report** për mesazhin, përdoruesin ose përvojën konkrete dhe zgjidhni arsyen e saktë.
- Përdorni **Block** që personi të mos kontaktojë më fëmijën.
- Ruani provat dhe njoftoni shkollën ose autoritetet përkatëse kur ka kërcënim, mashtrim, shantazh ose rrezik të menjëhershëm.